

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dhjetë të rregullt, e mbajtur më datën 21.11.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.53/2025/KG

**PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT NGA MBLEDHJA E KUVENDIT, E
MBAJTUR MË DATËN 28.10.2025**

Neni 1


Miratohet procesverbali nga mbledhja e nëntë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 28.10.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e nëntë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 28.10.2025.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e nëntë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 28.10.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 15 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 4 asamblistë: Vlladica Qurçiq, Sonja Odalloviq, Nebojsa Markoviq dhe Dushan Borisavljeviq. Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit të KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe zyrtarja nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e nëntë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të propozuar.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar të ditës:

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt, e mbajtur më datën 26.09.2025.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nëntëmujor financiar për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Informatat për fillimin e vitit shkollor dhe furnizimit të institucioneve arsimore me material ngrohës, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt, e mbajtur më datën 26.09.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nëntëmujor financiar për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se buxheti i Komunës së Graçanicës për tremujorin e tretë të vitit 2025 është 11,039,313.35 euro, nga të cilat për nëntë muaj është bërë alokimi i mjeteve në një shumë prej 9,489,561.49 euro. Për nëntë muaj janë shpenzuar 6,768,418.04 euro, ndërsa sipas kategorive ekonomike janë shpenzuar: për paga dhe mëditje 3,345,273.16 €, mallra dhe shërbime 1,204,673.52€, shpenzime komunale 196,043.72€, subvencione dhe transfere 485,124.94€, shpenzime kapitale 1,536,983.59€ dhe donacione 319.11€. Për nëntë muaj janë realizuar të hyrat vetanake në një shumë prej 2,251,055.00€ apo 82,48% nga të hyrat e planifikuara vetanake për vitin 2025 dhe të njëjtat janë alokuar në këto kategori ekonomike: mallra dhe shërbime 87,153.33€, shpenzime komunale 10,000.00€, subvencione 40,000.00€ dhe në investime kapitale janë alokuar 2,113,901.67€. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024 janë shpenzuar 148,559.15 € më shumë apo 2.24%, ndërsa të hyrat vetanake janë për 55,216.32 € ose 2.39% më të ulëta në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Informatat për fillimin e vitit shkollor dhe furnizimit të institucioneve arsimore me material ngrohës, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.

Zyrtarja në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, Miljana Bllagiq, tha se mësimi në kuadër të vitit shkollor 2025/2026 ka filluar më 1 shtator në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme sipas plan-programit të paraparë, në të cilat nxënësit e ndjekin mësimin në gjuhën serbe dhe shqipe.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës bashkëpunon me Policinë lidhur me përdorimin e drogave tek të rinjtë.

Miljana Bllagiq u përgjigj se drejtoresha ka pasur disa takime me përfaqësuesit e Policisë, por nuk e di se si është situata lidhur me këtë çështje.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se është i nevojshëm bashkëpunimi me Policinë dhe të organizohen ligjeratat me fëmijët për çështjen e sigurisë në komunikacion.

Miljana Bllagiq u përgjigj se lidhur me këtë çështje fillimisht duhet të përfshihen drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme dhe sigurisht që drejtoresha do t'i mbështesë ata dhe do t'u ofrojë të gjithë mbështetjen e mundshme.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, paraqiti informacion se në afërsi të shkollës në Sushicë, Gushtericë dhe Kishnicë do të vendoset matësi i shpejtësisë, i cili do t'i paralajmërojë vozitësit për shpejtësinë e tyre, si dhe që Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit duhet të përfshihen në realizimin e këtij projekti.

Zyrtarja në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, Miljana Bllagiq, njoftoi se sezoni i ngrohjes ka filluar në kohë dhe në përputhje me orarin e planifikuar dhe rregullat në fuqi. Sipas njohurive tona, të gjitha sistemet e ngrohjes janë vënë me sukses në funksionim, ndërsa furnizimi me energji ngrohëse zhvillohet me kapacitete të plota. "I kemi njoftuar të gjithë përdoruesit që të na njoftojnë me kohë përmes kërkesës, në mënyrë të reagojmë në kohën e duhur dhe të sigurojmë dru zjarri për të gjitha shkollat".

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Të ndryshme.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se ky Kuvend do ta ketë edhe një mbledhje tjetër, ku do të paraqitet raporti i punës së Kuvendit të komunës për mandatin katërvjeçar.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën "Të ndryshme" të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:13.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami

